



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Data: 25.8.2023

Nr: 731

Ora: 12:00

V E N D I M

P Ë R

**MATERIALET ZGJEDHORE QË DO TË PËRDOREN PËR ZGJEDHJET E PJESSHME PËR KRYETAR TË
BASHKISË KUKËS, TË DATËS 24 SHTATOR 2023**

Në mbështetje të nenit 19, pika 1, shkronja “n”, dhe 2, dhe të nenit 99, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve,

V E N D O S :

1. Në zgjedhjet e pjesshme për Kryetar të Bashkisë Kukës, të datës 24 Shtator 2023, do të përdoren materialet zgjedhore që plotësojnë karakteristikat e përcaktuara në vendimin nr. 223, datë 7.12.2022, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, “Mbi përdorimin në procesin zgjedhor të disa materialeve dhe përcaktimin e karakteristikave të përgjithshme të tyre në përdorim”.
2. Për vendosjen e materialeve zgjedhore do të përdoren kutitë e votimit, kapaku i të cilave do të jetë i vulosur me kodin e pestë nga KQZ dhe të identifikuara me shenja dalluese si kuti të materialeve zgjedhore.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve, brenda 24 (njëzet e katër) orëve nga shpallja e tij.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI